



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor  
Ministarstvo Životne Sredine i Prostornog Planiranja  
Ministry of Environment and Spatial Planning

|                      |                                                                                                                                                                                                                                             |
|----------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Për:                 | Ruzhdi Shehu, Kryetar i Komunës së Junikut<br>Leonard Lolluni, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Junikut                                                                                                                                    |
| Kopje:               | Elbert Krasniqi, Ministër në MAPL<br>Jeton Qela, Sekretar i Përgjithshëm në MAPL<br>Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL                                                                                                          |
| Përmes:              | Fitore Pacolli Dalipi, Ministre në MMPH<br>Bajram Kafexholli, U.D Sekretar i Përgjithshëm në MMPH                                                                                                                                           |
| Nga:                 | Florije Kika, Drejtore e Departamentit Ligjor në MMPH<br>Data: 29.04.2026                                                                                                                                                                   |
| Zyrtarët përgjegjës: | 1.Zyrtari konfirmues vlerësimit ligjor<br>2.Zyrtari hartues vlerësimit ligjor<br>Arta Krasniqi - Zyrtare e Lartë Ligjore në Divizionin për Bashkëpunim Ndërinstitucional në Fushën e Përfaqësimeve Gjyqësore dhe Koordinim të Marrëveshjeve |
| Lënda:               | Vlerësimi i ligjshmërisë së aktit                                                                                                                                                                                                           |
| Lloji i aktit:       | Vendim Nr.2-180/2263 për hapjen e diskutimit publik për plotësim ndryshim të projekt rregullores për menaxhimin e mbeturinave.                                                                                                              |

I nderuar kryetar Shehu,  
I nderuar kryesues Lolluni

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH), në pajtim me nenin 9 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave dhe Rregullores (Qrk) Nr. 03/2026 për Procedurën e Shqyrtimit Administrativ të Akteve të Komunave, me datë 08.04.2026 ka pranuar nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), **Vendim Nr.2-180/2263 për hapjen e diskutimit publik për plotësim ndryshim të projekt rregullores për menaxhimin e mbeturinave**

MMPH pas shqyrtimit të ligjshmërisë së aktit në fjalë, dhe në pajtim me nenin 8, 9 dhe 10 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave konstatoi se:

Ministria nuk është kompetente për të bërë vlerësimin e ligjshmërisë së vendimeve që kanë të bëjnë me hapjen e diskutimeve publike.

Megjithatë, në shkresën e bashkëngjitur me nr. prot. 2-155/1736, të datës 11.03.2026, është vërejtur se nuk është bërë thirrur në Ligjin Nr. 04/L-060 për Mbeturinat, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 08/L-071, por në ligj të shfuqizuar (Ligji Nr. 02/L-030 për Mbeturina). Andaj, rekomandojmë që të përmisohet referenca në Ligjin e duhur në fuqi.

MMPH mbetet në dispozicion të Komunës së Junikut dhe MAPL-së për çdo sqarim të mëtejshëm lidhur me këtë vlerësim.

